

SOCIALE

Shqetësimet e pushtetit vendor, takim në Bashkinë Kamëz i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë



FAQE 3

INVESTIME

Një projekt tjetër i Bashkisë në lagjen nr. 5 Kamëz, kanalizimet në rrugën "Deçani"



FAQE 4

KËNDI I BE-SË

Takim i kryebashkiakut Mziu me Orlando Fusco, Oficer Programi për Qeverisje të Mirë, i Delegacionit të BE-së



FAQE 8

NDËRHJRJA E BASHKISË

Vetëm 3 familje në gjithë territorin e Kamzës u dëmtuan nga reshjet



FAQE 6



Gazetë e Bashkisë Kamëz

KAMZA

E përdyjavshme
 Nr. 212 mars 2018
 Çmimi 20 lekë
 drmediakamez@gmail.com
 www.kamza.gov.al

BASHKIA KAMËZ, INVESTIME NË GJITHË TERRITORIN E SAJ

FAQE 4-5

Mbi 6000 familje në Kamëz janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike që nga viti 2013

Faqe 3

Bashkia Kamëz aplikon si lider projektin "BE EU Citizens: Building Europe through civic participation"

Faqe 8

Kryebashkiaku Mziu, takim me studentët e qytetit të Kamzës, përfitues të bursave për vitin akademik 2017-2018

Faqe 6

Edhe në Zall-Mner vijnë investimet e Bashkisë me ndërtimin e rrugës "Fan Noli" 500 metra e gjatë

Faqe 4



Mirëmbajtja e mjedisit, nismë e Bashkisë "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë"

FAQE 2



NË BRENDESI

Nismës së Bashkisë Kamëz për mbjelljen e pemëve i bashkohet edhe "World Vision"

FAQE 2

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, miratohen disa projektvendime nga ana e këshilltarëve

FAQE 6

Ndërtimi i rrugës "Hasan Zylfia" në Babrru-Kodër, investim që do të transformojë infrastrukturën e zonës

FAQE 4

Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore, përqendrim maksimal për realizimin e detyrave

FAQE 6

Vijon lirimi i hapësirave publike në rrugën "Ali Demi", Bulçesh

FAQE 5



Nisma e Bashkisë "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë", kryebashkiaku Mziu dhe prefektja Jahollari marrin pjesë në mbjelljen e pemëve

Kryebashkiaku Xhelal Mziu dhe prefektja Suzana Jahollari morën pjesë në mbjelljen e pemëve dekorative në rrugën "Arben Broci" në Paskuqan dhe në Qendër-Babrru. "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë" është nisma e Bashkisë Kamzë për shtimin e gjelbërimit. Ky projekt në tërësinë e tij do të mundësojë mbjelljen e rreth 20 mijë pemëve dekorative në gjithë territorin e Bashkisë Kamzë. Z. Mziu dhe znj. Jahollari mbollën 250 pemë të para dekorative në kuadër të nismës për një ambient sa më të përmirësuar për qytetarët e Kamzës.

"Kamza tashmë është një qytet, i cili edhe për shkak të numrit të popullsisë, por edhe për shkak të zhvillimit është një ndër qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë. Besoj se Kamza dhe Paskuqani, ku aktualisht jemi, ka një historik që i mungonte urbanizimi. Vetëm ditën e sotme, për shkak të kësaj nisme që ka marrë Bashkia e Kamzës në bashkëpunim me bizneset dhe me qytetarët e saj, ka bërë të mundur që të jenë më shumë se 250 pemë, të cilat do të mbillen në rrugë dhe qendra të caktuara të qytetit. Për shkak të kësaj nisme ka një sensibilizim maksimal të qytetarëve, të cilat janë jo të paktë dhe shpresoj që të shkojë numri i tyre në më shumë sesa 20 mijë", - është shprehur z. Mziu. "Kemi edhe një sipërfaqe të konsiderueshme, siç është Parku i Paskuqanit, i cili ka nevojë për mbjelljen e pemëve, në mënyrë që ta kthejmë në një park atraktiv për qytetin dhe më gjerë. Ajo çfarë është më kryesorja, është se qyteti tashmë nuk është si më parë. Ne jemi pirkëshit në një zonë, në Qendër të Babrrit, një qendër historike. Është një qytet më



shumë sesa 50-vjeçar dhe po ta shihni, ka ndryshuar. Dëshmitarë të këtij ndryshimi janë qytetarët e këtyre pallateve, ku gjashtë muaj më parë nuk kishin asnjë lloj mundësie për të pasur një infrastrukturë të tillë dhe pavarësisht se kishim një projekt rivitalizimi të qendrës urbane të Kamzës dhe të qendrës urbane të Paskuqanit, nuk u bë i mundur financimi i tyre nga qeveria shqiptare dhe sot, me taksat e këtyre qytetarëve, kemi bërë të mundur që të kemi bllokun më të mirë të rivitalizuar, që ka një sipërfaqe të konsiderueshme, me mijëra metra katrorë të asfaltuara, me ndriçim, me gjelbërim dhe me të gjitha standardet e nevojshme.

Duke u rikthyer te mbjellja e pemëve, - vijoi z. Mziu, - është një gjest shumë i rëndësishëm që duhet ta bëjë çdo qytetar, sepse të ardhurat e Bashkisë janë të pamjaftueshme për të mbyllur gjithçka ka qyteti. Në

emër të tyre do të dëshiroja t'ju kërkoja të bëheni pjesë e aksionit qytetar dhe të Bashkisë Kamzë për mbjelljen e pemëve dekorative për rrugët e qytetit dhe pyllëzimin e anësoreve të lumenjve", - tha ndër të tjera z. Mziu, i cili ishte i shoqëruar nga prefektja e Tiranës, znj. Suzana Jahollari.

Nisma për mbjelljen e pemëve dekorative në qytetin tonë fillon që nga viti 2007, i cili për fatin e keq nuk shënonte asnjë pemë dekorative të mbjellë brenda këtij territori. Gjatë viteve të fundit janë ndërtuar objekte publike e private, infrastrukturë e gjerë rrugore, por që është i nevojshëm kontributi i të gjithë faktorëve për qytetin, për brezat dhe për vetë natyrën, për mbjelljen e pemëve dekorative në rrugë, në hapësira publike, por që si dhe në anësoret e lumenjve që kalojnë në qytetin tonë. Ndërkaq, bashkë me prefektin Jahollari, z. Mziu inspektoi edhe bllokun në Qendër-Babrru, një investim madhor i Bashkisë Kamzë. Reforma territoriale bashkëngjiti edhe ish-komunën e Paskuqanit me Bashkinë Kamzë, e cila me buxhetin financiar planifikoi dhe investoi në qendrën e Njësisë Administrative Paskuqan, Babrru-Qendër mbi 25 km rrugë të standardeve bashkëkohore, me ndriçim, gjelbërim, dhe aksesore të tjerë për infrastrukturën. Vetëm rivitalizimi i Qendrës Urbane Babrru, një investim që i ka kushtuar jo pak Bashkisë, përfshin ndërtimin e rrugëve, trotuareve, ndriçimin, gjelbërimin, ndryshim fasade, stola dhe elemente të tjera ndihmëse për disiplinimin e mbetjeve (kosha mbeturinash).

Administrata e Bashkisë Kamzë dhe dy ndërmarrjet mbjellin mbi 1 mijë pemë të liqeni i Paskuqanit

Nisma e Bashkisë "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë" ka vazhduar dita-ditës duke gjetur mbështetjen e qytetarëve, bizneseve, OFJ-ve etj. Vetëm në tri ditë është mundësuar mbjellja e mbi 1 mijë pemëve falë kontributit të administratës së Bashkisë Kamzë si dhe dy ndërmarrjeve të vartësisë, ajo e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Pastrim-Gjelbërimit. Më konkretisht, janë mbjellë 320 pemë dekorative nga punonjësit e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit në digën e liqenit të Paskuqanit, në kuadër të nismës së Bashkisë "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë". Gjithashtu, është mundësuar mbjellja e 400 pemëve dekorative në argjinaturën e liqenit nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, kurse administrata e Bashkisë ka mbjellë



mbi 300 pemë.

Puna e palodhur si dhe nisma e kryebashkiakut Xhelal Mziu për të nxitur dhe rritur tempin e punëve në dobi të komunitetit ka gjetur mishërimin e saj edhe në këtë aksion që deri në përfundim të tij do të sigurojë mbjelljen e 20.000 mijë pemëve të reja dekorative në territorin e kësaj Bashkie. Në të gjitha ditët e këtij aksioni, ka marrë pjesë edhe kryebashkiaku Mziu, i cili gjatë inspektimit ka vlerësuar të gjithë aktorët që janë bërë pjesë e këtij procesi, duke u bërë thirrje edhe një herë të gjithë atyre që duan të ruajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për kontributin e tyre në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit në territorin e Bashkisë Kamzë.



Në këto ditë ishin të impenjuar punonjësit e ndërmarrjeve me të gjitha strukturat përfshirëse të saj, duke ndihmuar me hapjen e gropave dhe mbjelljen e këtyre pemëve dekorative për të ndryshuar tërësisht pamjen e këtij mjedisi.

Nismës së Bashkisë Kamzë për mbjelljen e pemëve i bashkohet edhe "World Vision", me mbjelljen e 70 pemëve selvi



Nismës së Bashkisë Kamzë për mbjelljen e pemëve i është bashkuar edhe organizata "World Vision", me mbjelljen e 70 pemëve selvi.

Bashkë me kryebashkiakun e Kamzës, z. Xhelal Mziu, ishte në këtë aksion edhe përfaqësuesja e "World Vision", znj. Blerina Lako. Ata mbollën pemë përgjatë rrugës "7 Marsi", në kuadër edhe të Ditës së Mësuesit. Organizata "World Vision" ka vite që kontribuon për fëmijët në nevojë në Bathore si dhe me projekte të ndryshme në shkollat e qytetit. "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë" është një prej nismave më të rëndësishme të Bashkisë Kamzë për shtimin e gjelbërimit dhe mirëmbajtjen e mjedisit.

Bashkia Kamzë kap shifrën e 105 mijë pemëve dekorative të mbjella në territorin e saj

Institucioni i Bashkisë Kamzë kap shifrën e 105 mijë e 874 pemëve dekorative të mbjella në territorin e saj. Kjo shifër sigurisht përbën një vlerësim për kujdesin që Bashkia i ka kushtuar mjedisit, krahas urbanizimit dhe shërbimeve të tjera në infrastrukturë. Kamza është qyteti më i ri i vendit, ku është investuar në mbi 200 segmente rrugore në territor, ku përfshihen edhe investime themelore si Bulevardi Blu, bulevardi "Berisha", bulevardi "Skënderbeu", bulevardi "Donald J. Trump", në Kamzë, bulevardi "Abdi bejToptani" në Valias, bulevardi "Demokracia" në Paskuqan, rruga "Demokracia në Bathore. Sigurisht që është një numër i konsiderueshëm rrugësh në

të cilat është investuar edhe me mbjelljen e pemëve dekorative si një element i rëndësishëm infrastrukturor. Mbjelljes së 105 mijë e 874 pemëve deri më tani i është bashkëngjitur edhe nisma e punonjësve të administratës së Bashkisë Kamzë "Jepi jetë Kamzës - Dhuro një pemë". Brenda një periudhe kohore të shkurtër është bërë e mundur që të realizohet ky investim i madh duke u kthyer tashmë qyteti i Kamzës si një nga territoret më tërheqëse që ka Shqipëria për shkak të ndryshimit rrënjësor të këtij të tij. Kryebashkiaku Xhelal Mziu mban edhe një premtim real në mandatin e tretë për të kthyer buxhetin e Bashkisë në urbanizim dhe gjelbërim të qytetit në çdo cep të tij.

Shqetësimet e pushtetit vendor, takim në Bashkinë Kamëz i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

Mars 2018
GAZETA KAMZA

3



Në mjediset e Bashkisë Kamëz u zhvillua një takim i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Takimi u hap nga kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu. Pasi përshëndeti për praninë në këtë takim të pranishmit, z. Mziu në fjalën e tij hyrëse paraqiti disa nga shqetësimet që ka sot pushteti vendor. Qeveria shqiptare vazhdon të akordojë grandin për pushtetin vendor në masën 1% të GDP-së, ku në këtë vlerësim raporti me pushtetet vendore që qeverisen nga të djathtët është në raportin 1 me 3 apo 1 me 4, duke mos përmendur Bashkinë Kamëz, për të cilën ky raport varion me masën 1 me 20. Pra, kjo panoramë diskriminuese financiare që sorollatet në dyert e qeverisë qendrore po thellon çdo ditë e më tepër shkallën e problematikave themelore të qytetarëve të këtyre bashkive.

“Po marrim rastin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, - u shpreh z. Mziu, - i cili ka financuar në shumë e shumë projekte ku për hir të së vërtetës, Bashkia Kamëz nuk ka përfituar qoftë edhe një projekt të vetëm. Por ky shqetësim nuk është vetëm për Bashkinë Kamëz, por edhe për mjaft kolegë të djathtë dhe bashkitë që drejtojnë, të cilat nuk janë përfituese. Kjo është një tjetër ndasi ku politikisht janë diskriminuar bashkitë e djathta. Pa u thelluar shumë, vetëm po të kapim rastin e ujësllës-kanalizimeve, ku Bashkia Kamëz ka qenë e privuar pikërisht nga investimet në këtë linjë, edhe pse është njësi administrative më nevojtare për implementimin e projekteve të tilla, duke anashkaluar qenësisht këtë interes



qytetar. Delegimi i kompetencave është një tjetër komponent ku asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Edhe pse kemi 45% mungesë personeli parauniversitar dhe po në të njëjtën shifër të personelit ndihmës, ligjërisht kjo kompetencë duhet t'i kishte kaluar pushtetit vendor. Një tjetër kompetencë është dhe ajo e kalimit të bordeve të kullimit në drejtim të pushtetit vendor dhe është i njëjti standard, ku qeveria qendrore, përveç delegimit të strukturës organike asnjë lloj kompetence tjetër. Apo kompetenca e zjarrfikëseve e cila realizohet nga Bashkia Tiranë dhe për shërbimet të cilat as shikohen dhe as njoftohen, vendoset fatura financiare dhe ajo tatimore”, - tha ndër të tjera kryebashkiaku Mziu.

Dështim i skemës së ndihmës ekonomike, diskriminim i familjeve të varfra të Kamzës dhe gjithë Shqipërisë



Në takimin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, që u zhvillua në Bashkinë Kamëz, një çështje që u ngrit me shumë shqetësim dhe me forcë ishte edhe dështimi i skemës së re të ndihmës ekonomike, si dhe diskriminimi që u bëhet familjeve në nevojë. Duke u shprehur për rastin e Kamzës, kryebashkiaku Xhelal Mziu u shpreh: “Nga viti 2013 që po e marrim si referencë, trajtimi i familjeve me ndihmë ekonomike ra me 4500 familje pas ardhjes në pushtet të Edi Ramës dhe duke vazhduar me heqjen nga sistemi çdo muaj 50-100 familje dhe së fundmi kanë larguar nga skema rreth 750 familje dhe aty ku qeverisin të djathtët numri i tyre është rreth 12.000 familje. Pa folur këtu për vështirësitë e pafundme që po shoqërojnë familjet shqiptare në këto vite të qeverisjes së të majtëve. Duhet theksuar se kjo qeveri e cila kishte në programet e saj politikave sociale, jo vetëm që nuk mbajti premtimet e dhëna, por veçoi në kahun e kundërt të mirëqenies së tyre. Në Bashkinë Kamëz ka larguar nga skema e ndihmës ekonomike kryefamiljare gati 90% të familjeve, të cilat nuk merrnin vlerësimet e duhura pa analizuar në sistem arsyet e largimit dhe për më tepër duke fshehur transparencën”. Pas z. Mziu diskutuan për këtë çështje mjaft të rëndësishme edhe kryebashkiakët e tjerë dhe në fund u dol me një deklaratë të përbashkët për shtyp, ku kryetarja e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë njëkohësisht dhe kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, lexoi qëndrimet ndaj qeverisë qendrore. Kryebashkiakët vizituan edhe disa familje të Kamzës, ku panë gjendjen e mjerueshme të tyre, denigrimin

e tyre pas përjashtimit nga skema e ndihmës ekonomike, për arsye të “mosplotësisht të pikëve”!

Deklaratë për shtyp e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, përmes zëvendësministres znj. Kospiri, paska reaguuar lidhur me shqetësimin e ngritur prej ditësh nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë për dështimin e skemës së re të ndihmës ekonomike. Në mënyrë të çuditshme por edhe tallëse flitet për nxjerrje jashtë skeme të abuzuesve! Kjo tregon se znj. Kospiri nuk ka informacionin e duhur apo se thjesht po flet politikisht. Në mbarë Shqipërinë, janë me qindra e mijëra familjet me anëtarë persona me aftësi ndryshe që janë përjashtuar nga skema. Madje, duke mos pasur asnjë të ardhur tjetër. Qeveria flet për një “sistem të ri transparent”. Por në asnjë rresht nuk ka një sqarim lidhur me pikëzimin apo cilat janë kriteret që përjashtojnë nga përfitimi i ndihmës familjet më në nevojë në vendin tonë. Numri 2 i ministrisë së linjës paraqet disa raste sporadike të përjashtimit nga lista të atyre që mund të kenë përfituar ndihmë ekonomike padrejtësisht. Por ne si qeverisje vendore, mund të tregojmë mijëra familje që sot nuk kanë as bukë e gojë. Vetëm në bashkitë e djathta janë më se 2000 familje me persona me aftësi ndryshe, të cilave u është mohuar e drejta ligjore për të përfituar nga kjo skemë. Zonja në fjalë përpigjet të tregojë se ku shkojnë lekët e ndihmës ekonomike kur është përgjysmuar numri i përfituesve si pasojë e dështimit të skemës së re. Pse nuk ka një shifër të saktë, sa ishte ky fond në dhjetor 2017 dhe sa është sot në janar 2018? Sa ishte numri i familjeve përfituese në dhjetor 2017 dhe sa është ky numër në janar 2018? Është e qartë se qeveria po u zhvat paratë familjeve më në nevojë, duke përgjysmuar buxhetin. Tallja vazhdon duke e pranuar se kanë mbetur shumë familje të varfra jashtë kësaj skeme dhe u kërkohet të riaplikojnë. Si mund të riaplikojnë në sistem mijëra familje për vetëm 2-3 ditë, a mund ta thotë këtë znj. Kospiri. Dhe e fundit, Qeveria thotë “të gjitha Bashkive u është dhënë një fond prej 6% të fondit të ndihmës ekonomike për këto familje që nuk plotësuan kriteret për t'u futur në sistem.” Po sa është ky fond, dhe hallin e sa familjeve mund të zgjidhë? Pra, bëhet fjalë për 6% të një fondi që është përgjysmuar në shkallë vendi, ndërsa jashtë skemës kanë mbetur mbi 40-70% e aplikuesve! Duhet ta dijë mirë znj. zëvendësministre dhe të gjithë ata që janë pas saj! Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, kryetarët e Bashkive dhe Këshillat Bashkiakë janë në krah të qytetarëve. Ne jemi në kontakt çdo ditë me ta, jetojmë me hallet e problemet e tyre. Nuk mund të bëhet demagogji, apo më keq të mashtrohet kur kemi të bëjmë me kafshatën e bukës së përditshme të qindra e mijëra familjeve shqiptare në mbarë vendin.

Mbi 6000 familje në Kamëz janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike që nga 2013

Varfëria ka pllakosur të gjithë vendin, ndërsa hakmarrja politike ndaj qytetarëve të Kamzës në nevojë u hiqte mundësia e fundit për mbijetesë. Që nga 2013 janë larguar padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike mbi 6000 familje. Kjo situatë erdhi qysh në ardhjen në pushtet të atyre që premtuan politika thellësisht sociale për mbrojtjen e shtresave në nevojë. Në vitin 2013 largohen në mënyrë të menjëhershme rreth 4500 familje nga kjo skemë me qëllimin e vetëm për të filluar një luftë të ashpër politike ndaj qytetarëve të Kamzës. Vit pas viti ky proces arriti të ulte numrin e përfituesve dhe sot numërohen në gjithë Bashkinë Kamëz 1306 familje, ndihmë e cila përsëri do të vijë deri në minimizim apo përjashtim total nga kjo skemë. Dhe për faktin se vlera mesatare e ndihmës ekonomike është në masën 4000 (katër mijë) lekë të reja në muaj, ku këto përfitime nga kjo skemë shkojnë për pagesën e energjisë elektrike.



Me çfarë jetojnë këto familje?

Përveç lëmshës asnjë gjë nuk i motivon pasi dhe politikant dhe punësimit janë të shteruara. Nuk mbetet gjë tjetër vetëm që qytetarët e Kamzës të mbështeten te shpresa e vetme e tyre për t'u bërë pjesë e emigrimit për të shpëtuar jetët e tyre dhe ta lënë mundësinë për të jetuar në vendin e tyre.

Qeveria largon edhe 700 familje të Kamzës nga skema e ndihmës ekonomike

Qeveria shqiptare, sapo ka filluar viti 2018, në Kamëz e Bathore ka larguar nga skema e ndihmës ekonomike 700 familje. Programi i kësaj qeverie vazhdon të mbetet varfërimi ekstrem i familjeve shqiptare, por më e thelluar kjo mbetet për qytetarët e Kamzës. Edhe pse institucionet që monitorojnë programet e mirëqenies e kanë nxjerrë qytetin e Kamzës si më i varfri në Shqipëri, ku 1 në 10 fëmijë ushqehen vetëm me një vakt ushqimor, përsëri kjo politikë diskriminuese vazhdon të zbatohet me një orientim të qartë qeveritar. Rasti i paprecedentë i largimit të 700 familjeve nga skema e ndihmës ekonomike e shton më thellë egërsinë e dikasterit që mbulon çështjet sociale, pasi në 90% të këtyre familjeve kryefamiljare janë nënat, që jo vetëm i kanë shumë të kufizuara mundësitë e punësimit, por edhe statusi i tyre është i tillë që kërkon një vëmendje shumë të përqendruar dhe jo hedhje totale në rrugë të madhe. Edhe pse Bashkia Kamëz ka kërkuar, por njëkohësisht ka denoncuar me forcë rast pas rasti keqtrajtimin e qytetarëve të saj, përsëri nuk kemi reagim për përmirësimin e situatës nëpërmjet programeve të mirëqenies nga ana e ministrisë së linjës. Mbetet t'u bëhet thirrje të gjitha institucioneve ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë për të kontribuar për këtë çështje jetike dhe t'i kërkojë qeverisë shqiptare të normalizojë situatën për qytetin dhe qytetarët e Kamzës, si në probleme sociale, por edhe ato që ligjërisht janë të zbatueshme.



Bashkia Kamëz, investime në gjithë territorin e saj

Ndërtimi i rrugës “Prengaj” në Babrru, Fushë-Kërçik, është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz i planifikuar brenda vitit 2018. Investimi në rrugën “Prengaj” ka një gjatësi prej 686 metrash linearë, me gjerësi 7 metra, gjerësi asfalti 4.5 metra, me kanalizime të ujërave të bardha dhe me bankina.

Këto elemente të përfshira në përbërjen e investimit sjellin një impakt infrastrukturor, si dhe një përmirësim ambientit të menjëhershëm për të gjithë banorët që preken nga investimi. Investimi i rrugës “Prengaj” është financim 100% i buxhetit të Bashkisë Kamëz, e cila vazhdon të ndjekë një politikë të kthimit të taksave dhe tatimeve në pjesën dërmuese të tyre në këtë destinacion.

Familjet përfituese të investimit kanë një solidarizim të menjëhershëm, duke krijuar një bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Bashkisë, duke ndihmuar në lehtësimin e realizimit të investimit dhe duke ndihmuar drejtpërdrejt në lirim të hapësirave publike.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu po bën realitet të gjitha premtimet e bëra për ndryshimin e menjëhershëm të gjendjes infrastrukturore në gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.



Investimet e Bashkisë Kamëz për vitin 2018 vijojnë me ndërtimin e rrugës “Kaci” në Babrru të Vjetër, me gjatësi 705 metra

Një tjetër investim i rëndësishëm i planifikuar të realizohet nga Bashkia me buxhetin e saj është edhe rruga “Kaci” me vendndodhje në Babrru të Vjetër. Ky investim do t’u shërbejë më shumë se 300 familjeve, të cilat kanë vuajtur për një kohë nga mungesa e investimeve. Rruga ka një gjatësi prej 705 metrash linearë, që krahas ndërhyrjeve në sistemim, asfaltim do të ketë dhe të gjitha elementet e tjera të domosdoshme për një infrastrukturë



me të gjithë aksesorët e dëshiruar. Gjelbërimi do të jetë një tjetër element i infrastrukturës që do të shoqërojë investimin në rrugën “Kaci” në Babrru të Vjetër. Buxheti i Bashkisë është shndërruar në një pjesë mjaft të konsiderueshme në destinacion investime në infrastrukturë, sistemet e ujësjellës-kanalizimeve si dhe në shërbime, mbrojtje ambientit nëpërmjet mbjelljeve të pemëve dekorative në çdo rrugë të strukturuar të qytetit si dhe parqe e lulishte.

Një investim tjetër i Bashkisë në lagjen nr. 5 Kamëz, kanalizimet në rrugën “Deçani”

Në buxhetin e sapomiruar është planifikuar një tjetër investim në lagjen nr. 5 Kamëz. Bëhet fjalë për KUN tek rruga “Deçani” me një gjatësi lineare prej 230 metrash. Nga ky investim përfitojnë më shumë se 200 familje, të cilat deri më sot kanë vuajtur nga nevoja të tilla të cilat kanë qenë mjaft problematike.

Banorët e kësaj lagjeje dhe të mbarë Bashkisë Kamëz duhet të kuptojnë më së miri që taksa simbolike prej 200 lekësh në muaj nuk mjafton për të realizuar investime të tilla. Por Bashkia ka arritur të realizojë projekte të kthyer në investime të domosdoshme për çdo qytetar të kësaj Bashkie. Investimi në KUN rruga “Deçani” do të investohet me tuba betoni me diametër 400 Ø. Ky investim është një ndër 70-80 investime themelore që Bashkia Kamëz ka planifikuar të investojë tërësisht me buxhetin e saj të planifikuar për vitin 2018.



Edhe në Zall-Mner vijojnë investimet e Bashkisë me ndërtimin e rrugës “Fan Noli” 500 metra e gjatë



Edhe në Zall-Mner do të vijojnë investimet e Bashkisë, me ndërtimin e rrugës “Fan Noli”, 500 metra linearë e gjatë. Ky projekt është planifikuar të realizohet në vitin 2018, me të ardhurat e parashikuara nga buxheti i këtij viti në Bashkinë Kamëz. Mes dhjetëra projekteve që do të zbatohen në Kamëz, është ndërtimi i rrugës “Fan Noli” në lagjen e Zall-Mnerit. Ky investim merr një rëndësi të veçantë, sepse pas realizimit të tij do të ketë një infrastrukturë rrugore bashkëkohore edhe në këtë zonë. Gjerësia e saj do të jetë 5 m. Përveç përmirësimit të infrastrukturës, lehtësimit të lëvizjes, realizimi i këtij projekti do të ndikojë edhe në zhvillimin e bizneseve. Prej kësaj do të përfitojnë qytetarët e kësaj zone, duke pasur më shumë mundësi për punësim dhe për rritjen e nivelit të jetesës. Në këtë mënyrë, projektet zhvilluese të Bashkisë do të përfshijnë çdo cep të qytetit, pa lënë asnjë lagje apo zonë jashtë listës së investimeve. E gjitha kjo punë e Bashkisë Kamëz bëhet e mundur vetëm falë të ardhurave të saj, mirëmenaxhimit të tyre, duke u përkthyer në investime dhe shërbime cilësore për qytetarët.

Ndërtimi i rrugës “Hasan Zylfia” në Babrru-Kodër, investim që do të transformojë infrastrukturën e zonës

Ndërtimi i rrugës “Hasan Zylfia” në Babrru-Kodër është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz që do të transformojë infrastrukturën e zonës, ashtu siç janë transformuar edhe lagje të tjera të qytetit.

Edhe pse pa asnjë mbështetje financiare nga qeveria për pesë vite rresht, Bashkia ia ka dalë që të realizojë investime, madje projekte madhore për qytetarët e vet. Këtyre qytetarëve që i përbuz Kryeministri aktual, Bashkia u ka shërbyer dhe do të vazhdojë t’u shërbejë në mënyrë cilësore, korrekte, si dhe të investojë në çdo zonë të qytetit, në rrugë, në ujësjellës, në kanalizime, në shkolla, kopshte, objekte sportive dhe kulturore etj.

Por investimet e Bashkisë Kamëz nuk do të ndalojnë as në vitin 2018, një prej tyre është edhe ndërtimi i rrugës “Hasan Zylfia”, me gjatësi 556 metra linearë, 6.5 m gjerësi, me KUN dhe bankina.





Ndërtimi i rrugës “Loro Boriçi” në Njësinë Administrative Bathore, ndikim i rëndësishëm në infrastrukturë

Mars 2018
GAZETA KAMZA



5

Një investim tjetër i parashikuar në buxhet është edhe ai i kryer në segmentin e rrugës “Loro Boriçi”. Ky investim i planifikuar gjatë vitit 2017 përfundoi me të gjithë parametrat e preventivave që përshkruajnë zërat e punimeve. Rruga “Loro Boriçi” është një segment prej 210 metrash linearë, me një bazë asfaltimi prej 4 m dhe me një strukturë të kunetëve në të dy krahët e bazës së asfaltuar me dimensione 2 x 0.4 m, në të dy krahët e këtij segmenti ka trotuare me përmasa 2 x 0.6 m. Ky segment rrugor lidh rrugën “Besëlidhja” me rrugën “Azem Hajdari”, duke bërë të mundur lidhjen në një mënyrë organike këto tri segmente mjaft të rëndësishme për një numër të konsiderueshëm të familjeve dhe bizneseve që operojnë në këtë zonë.



Investimi në rrugën “Loro Boriçi” është vërtet një shembull i ndryshimit rrënjësor të infrastrukturës në këtë mjedis, por ka edhe një impakt shumë me vlera për mbarë qytetarët që lëvizin në këtë rrugë.

Qytetarët përfitues të këtij investimi vlerësojnë maksimalisht punën e bërë nga strukturat e Bashkisë si dhe premtimet e bëra gjithnjë realitet të kryebashkiakut Xhelal Mziu.

Rruga “Zigur Lelo” në Babrru-Shpat, investim i Bashkisë për vitin 2018

Rruga “Zigur Lelo” në Babrru-Shpat është një investim tjetër i Bashkisë Kamëz për vitin 2018. E parashikuar të financohet me fondet e buxhetit të këtij viti, ndërtimi i kësaj rruge do t’u shërbejë qindra familjeve të zonës. Me realizimin e projektit, i cili është me të gjithë parametrat bashkëkohorë, infrastruktura urbane e zonës do të ketë përmirësim dhe zhvillim të madh. Impakti i investimit do të jetë i jashtëzakonshëm. Bashkia Kamëz çdo ditë po ndërthron në territorin e saj me investime



të të gjitha llojeve, por më parësoret mbeten investimet në infrastrukturë dhe në mirëmbajtjen e mjedisit të qytetit, pa lënë në harresë edhe fusha të tjera apo shërbimet e ofruara qytetarëve dhe subjekteve private. Rruga “Zigur Lelo” në Babrru-Shpat ka një gjatësi prej 180 metrash linearë dhe gjerësi 5 m. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor është vetëm një pjesë e vogël e punëve të Bashkisë Kamëz, e cila gjatë këtij viti do të realizojë mbi 70 projekte të reja.

Në vitin 2018, Bashkia do të ndërtojë rrugën “Roma” në lagjen 1 Kamëz, një e rëndësishme lidhëse mes rrugëve të qytetit

Një investim që do të realizohet brenda këtij viti është dhe rruga “Roma”, që ndodhet në lagjen nr. 1 Kamëz. E parë në kontekstin infrastrukturor, ky segment rrugor që lidh rrugën “OSBE” me Bulevardin Blu, është një investim prej të cilit përfitojnë mbi 250 familje, si dhe dhjetëra subjekte private së bashku.

Nga realizimi i këtij projekti do të krijohet një ambient shumë më tërheqës se gjendja e deritanishme. Rruga “Roma” kap një gjatësi lineare prej 340 ml, me një bazë asfaltimi 5 m e gjerë, si dhe me të gjitha elementet e tjera të domosdoshme infrastrukturorë.

Lehtësimi i lëvizjes së mjeteve si dhe këmbësorëve bën që të ketë një rrjet komunikimi lehtësues dhe shumë favorizues për ta.

Në këtë kontekst vazhdon politika që kryebashkiaku Xhelal Mziu ka deklaruar për kthimin e pjesës më të konsiderueshme të buxhetit në investime.

Ky vizion vazhdon të ndihet çdo ditë në Kamëz, duke



parë ritmet e ndryshimit në vazhdimësi të qytetit.

Vijon lirimi i hapësirave publike në rrugën “Ali Demi”, Bulçesh

Strukturat e IVMT-së kanë vijuar punën me lirin e hapësirave publike përgjatë rrugës “Ali Demi” në Bulçesh. Lirimi i tyre bëhet në kuadrin e planifikimit të investimeve në këtë segment rrugor. Ky segment është mjaft i rëndësishëm edhe për pozicionin gjeografi ka që ka kjo rrugë, duke lidhur tri segmente kryesore me Rrugën e Arbrit dhe duke lehtësuar ndjeshëm lëvizjen e familjeve që deri më tani kanë hasur në vështirësi të mëdha. Aksioni i kryer nga IVMT-ja është mbështetur edhe nga inspektorët e Policisë Bashkiake, të cilët kanë gjetur edhe bashkëpunimin me familjarët që përfshihen në mjediset përgjatë rrugës “Ali Demi”.

Ndërhyrja për lirin e këtyre hapësirave është kryer sipas një udhëzimi që kryebashkiaku Xhelal Mziu u ka dhënë të gjitha strukturave përgjegjëse për ekzekutimin e këtyre shërbimeve, ku brenda një kohe shumë të shkurtër Bashkia do të ndërhyjë duke kryer



investimin në këtë segment rrugor. Bashkia vazhdon të urbanizojë çdo ditë në çdo lagje qyteti, pa diferencime terriore, por duke krijuar strategji reale për investimet e radhës.

Ndërtimi i rrugës “Konferenca e Mukjes” në Kodër të Kuqe, tjetër investim me rëndësi për vitin 2018



Ndërtimi i rrugës “Konferenca e Mukjes” në Kodër të Kuqe, me gjatësi 1810 metra linearë, ka një rëndësi të madhe, si ekonomike ashtu edhe sociale. Ajo ndikon në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe të njerëzve, duke lehtësuar lëvizjen e komunitetit në atë zonë, duke e lidhur atë me zonat e tjera të Paskuqanit dhe të Kamzës. Zona ku kalon rruga, ka një pozicion favorizues, për vetë faktin se lidh shumë banesa dhe u jep zgjidhje shumë problemeve që mund të ekzistojnë aty. Gjithashtu, ajo lehtëson edhe lëvizjen e nxënësve të kësaj lagjeje. Ky është një tjetër investim me rëndësi i Bashkisë Kamëz për vitin 2018, i parashikuar të financohet me të ardhurat e vetë Bashkisë. Duke qenë një zonë në zhvillim e sipër, është pasur parasysh që kjo rrugë të bëhet me parametra që t’i përshatën këtij zhvillimi, si dhe të jetë e standardeve bashkëkohore. Gjatësia e saj do të jetë L = 1810 ml, gjerësi totale = 8.5 m, gjerësi asfalti 5 m. Kjo rrugë aktualisht është funksionale, por në zgjidhjen planimetrike është pasur parasysh që asfaltimi i rrugës dhe parametrat e tjerë të saj të jenë bashkëkohorë.



Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, miratohen disa projektvendime nga ana e këshilltarëve

Në sallën e mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë Kamëz u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, ku u miratuan projektvendimet nga ana e këshilltarëve.

Rendi i ditës i mbledhjes përmbante këto pika:

-“Për dhënien e Ndhmës Ekonomike për përdhën 1- 28.2.2018”;

-“Për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1- 28.2.2018 për personat me aftësi të kufizuara dhe invalidët e punës”;

-“Për dhënien e kompensimit të energjisë elektrike janar 2018”.

-“Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% i familjeve që nuk kanë përfituar nga sistemi elektronik i pikëzimit për muajin shkurt 2018”;

-“Për rastet e veçanta janar 2018”;

-“Për miratimin e plotësimit të mangësive të listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim nga pushteti qendror në Bashkinë Kamëz për pronat me numër rendor nga 4-18 dhe



numër rendor 31-39, sipas VKM-së nr.481 date 30.5.2013”;

-“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim nga pushteti qendror në Njësinë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz”;

-“Mbi miratimin e listës paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që kërkohen të transferohen nga pushteti qendror në pushtetin vendor, Bashkia Kamëz (Kamëz dhe Paskuqan)”;

-“Mbi miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2017”;

-“Mbi miratimin e festës lokale të Bashkia Kamëz”;

-“Lënie në fuqi të VKB-së nr. 16 dt. 1.2.2018 “Mbi ndryshimin e VKB-së nr.104, datë 19.8.2016 “Për miratimin e vend-depozitimit të mbetjeve urbane (landfill) prej 5 ha në Valias” lënë në fuqi me VKB-në nr. 114, datë 19.9.2016”.

Drejtorja e Tarifave dhe Taksave Vendore, përqendrim maksimal për realizimin e detyrave

Drejtorja e Tarifave dhe Taksave Vendore në Bashkinë Kamëz vazhdon punën me një përqendrim maksimal për realizimin e detyrave. Organizimi i 15 grupeve në terren të harmonizuar si një ekip i plotësuar ka bërë që brenda një periudhe 1-mujore të ketë ndikim të menjëhershëm dhe ndërgjegjësimit real të shlyerjes së detyrimeve të subjekteve, qofshin këto biznese apo subjekte familjare. Qëllimi i funksionimit të grupeve është informimi i plotë në lidhje me detyrimet dhe afatet kohore që subjektet kanë ndaj zbatimit të ligjit dhe mirëkuptimit të përbashkët për të qenë partnerë në luftën ndaj informalitetit.

Deri më tani ka pasur një mirëkuptim të përbashkët, pa komplekse, për të kryer pagesat normalisht pranë sporteleve të shërbimit në Bashki. Funksionimi i grupeve të punës në terren ka shërbyer si për njohjen ashtu edhe për sensibilizimin për të gjitha kategoritë e taksave vendore, përfshirë këtu edhe ato të ujësjellës-kanalizimeve. Ky strukturim po sjell rezultate mjaft të ndjeshme për buxhetin e Bashkisë si dhe premisë për investime dhe shërbimeve ndaj qytetarëve të saj.

Bizneset e vogla në Kamëz, edhe pse kanë gjetur një hapësirë të duhur politikash taksash, duke mundësuar ushtrimin lirish të aktivitetit të tyre, sistemi i vendosjes së TVSH-së nga qeveria për kategoritë që përfshijnë xhiro vjetore nga 2.000.000-8.000.000 lekë të reja po i shkaktojnë një vështirësi të pa llogaritur këtyre. Tashmë në Bashkinë e Kamzës ushtrojnë aktivitetin rreth 3000 biznese, të ndara 2580 biznese të vogla dhe 420 biznese të mëdha. Bashkia po përdor politikën e saj stimuluese për të nxitur dhe rritur aktivitetin e tyre brenda territorit të saj, duke stimuluar nëpërmjet këtyre politikave fiskale që të vijnë edhe kompani të tjera nga të gjitha qytetet e vendit apo të huaja, sepse në Kamëz do të gjejnë mjedisin e favorshëm për të ushtruar aktivitetin e tyre privat.

Ndërhyrja e Bashkisë, vetëm 3 familje në gjithë territorin e Kamzës u dëmtuan nga reshjet e fundit



Nga reshjet e dendura që përfshinë edhe territorin e Bashkisë Kamëz, vetëm 3 banesa janë dëmtuar. Këto eliminime masive të përmytjeve erdhën, pasi brenda një kohe jashtëzakonisht të shkurtër Bashkia ndërhyri me investime me një shifër 4 milionë lekë të reja në kolektorët e ujërave të larta, por edhe në pikat nevralgjike që shkaktonin pikërisht këto përmytje. Edhe pse vazhdon puna intensive me projekte dhe zbatimin e tyre duke i shndërruar në investime sigurisht që sakrifkohen shumë zëra të buxhetit. Kjo ka bërë që të ndryshojë destinacioni i tyre, në një kohë kur nuk janë dhënë kompetencat e deleguara nga ana e qeverisë qendrore për pushtetin vendor, gjë që mbetet një hallkë e vështirë pikërisht për sipërmarrjet e duhura në dobi të qytetarëve. Qeveria shqiptare vazhdon të ruajë indiferencën për të gjitha shërbimet që kërkon Bashkia Kamëz për të përmbushur detyrimet ligjore si në shërbime ashtu dhe investime. Edhe pse është investuar shumë në të gjitha drejtimet brenda territorit të Bashkisë, institucioni po vazhdon nëpërmjet rrjetit të gjerë të komunikimeve për të rritur praninë e donatorëve të huaj për investime themelore, pasi janë të gatshme më shumë se 150 projekte me parametra bashkëkohorë, por që nuk është financuar asnjë nga ana e qeverisë.

Kryebashkiaku Mziu, takim me studentët e qytetit të Kamzës, përfitues të bursave për vitin akademik 2017-2018



Në sallën e Këshillit Bashkiak, kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në takim studentët e qytetit të Kamzës, përfitues të bursave të studimit për vitin akademik 2017-2018. Në fillim, z. Mziu i përshëndeti studentët duke u uruar suksese në sezonin e provimeve, duke inkurajuar tempin me të cilët duhet t'i karakterizojë këta të rinj për arritjen e rezultateve sa më të larta.

Bashkia Kamëz pati 100 kërkesa për bursa studentore, të cilat për hir të së vërtetës plotësonin të gjitha kriteret e përfitimit, por në finale u akorduan vetëm 15 bursa për studentët e viteve të para për Bashkinë Kamëz. Kjo është një tjetër sjellje e nënvlerësuar që bën qeveria qendrore ndaj studentëve të cilët jetojnë në qytetin e Kamzës, duke lënë pjesën më të mëdha jashtë të drejtave themelore të përfitimit ligjor të një burse studimi.

“Sa për analogji, në Bashkinë Korçë kjo qeveri me të njëjtin Ministri akordoi 420 bursa studimi ku kërkesa për to pati vetëm 150, të cilat u shpërndanë totalisht, duke kursyer 270 bursa studimi. Ky është një moment memorieje për të gjithë ju të rinj që sot ndani mes jush 30 gjysma burse, duke ngushëlluar njëri-tjetrin, për shkak të politikave planifikuese dhe shpërndarëse të një të drejte themelore për njeriun. Ne jemi fokusuar kryesisht në dhënien e këtyre gjysma burse tek studentët, përbërës të familjeve në shumë nevojë, që trajtohen me ndihmë ekonomike ku numri i këtyre familjeve tashmë arrin në 1000 të tilla në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. Nga një statistikë momentale përmendim që papunësia në Kamëz i kalon të 30 apo më tepër për qind dhe si rrjedhojë nga 45.000 familje që ka qyteti i Kamzës, nga 12 deri në 13.000 familje ndodhen në gjendje të tejskajshme varfërie sot numërohen vetëm 1000 familje të tilla që trajtohen. Megjithatë, unë dua të theksoj se përpjekjet tuaja do të jenë të tilla për të qenë nju burim i sigurt intelektual që do të kujdeseni për zhvillimin e mëtejshëm të Kamzës dhe përmirësimit çdo ditë e më tepër të jetës së qytetarëve të këtij qyteti”, - u shpreh në fjalën e tij kryebashkiaku Mziu.



7 Marsi – datë emblematike e historisë, arsimit dhe kulturës shqiptare

KShtatë marsi është një nga datat më të rëndësishme të kulturës dhe historisë së popullit shqiptar në gjithë hapësirën e tij etnike. Kjo është data kur me 7 mars 1887 u themelua shkolla e parë laike dhe publike shqipe në qytetin e Korçës. Mirëpo kjo nuk do të thotë se më herët nuk ka pasur shkolla të tjera në Shqipëri, sepse sipas burimeve historike thuhet se shkolla ka pasur edhe më herët, por ato funksiononin në gjuhë tjera të huaja dhe ishin shkolla fetare.

Rëndësia e 7 marsit, si datë e themelimit të shkollës së Korçës, është shumëdimensionale, sepse përmes kësaj shkolle dhe shkollave të tjera të mëvonshme orientohet tërë veprimtaria iluministe e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Pra kjo shkollë filloi të bëhet një nga burimet e përhapjes së dijes dhe vlerave të tjera kulturore dhe qytetëruese, përmes të cilave intensifikohet ideja dhe vizioni i Rilindjes Kombëtare Shqiptare për çlirim dhe pavarësi.

Koha e hapjes së kësaj shkolle korrespondon me periudhën pas Lidhjes së Prizrenit dhe lëvizjen për çlirim dhe pavarësi, kur këto vlera arsimore do të shërbejnë për dinamizimin dhe masivizimin e idesë së zgjidhjes së çështjes kombëtare. Hapja e kësaj shkolle dhe e shumë shkollave të tjera më vonë, të cilat do të përgatisin kuadro për punë edukativo-arsimore për ushtrimi e veprimtarisë e mirëfilltë arsimore, ishte një përmbushje e dëshirave dhe kërkesave të rilindësve shqiptarë.

Shkolla e Korçës, si institucion formal kulturor dhe edukativo-arsimor ishte krenaria e kombit shqiptar, sepse veprimtaria e saj përqendrohet në arsimimin, emancipimin dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, vlera të cilat për kohën e atëherëshme ishin nevojë ekzistenciale. Rezultati i tërë kësaj veprimtarie edukativo-arsimore të shkollës së Korçës e shkollave të tjera ishte socializimi i përgjithshëm e veçanërisht socializimi politik i popullit shqiptar. Ky lloj socializmi, i cili buron nga vlerat arsimore të këtyre shkollave, ndikoi fuqishëm jo vetëm në ngritjen dhe intensifikimin e njohurive dhe shkallës së nacionalitetit, por edhe në ngritjen e vetëdijes për njohjen e vetvetes, ngritjen e atdhedashurisë dhe të kuptuarit e përmbajtjes së elementeve filozofiko-juridike dhe sociologjike të lirisë. Rilindësit ishin iniciatorë të ndryshimeve të mëdha në shoqëri, por këto ndryshime i shihnin si rezultat i hapjes së shkollave dhe masovizimit të veprimtarive të tyre edukativo-arsimore, të vetëdijshëm se arsimimi skolasik duhet të zëvendësohet me një arsimim të mirëfilltë laik gjithëkombëtarë, i cili do të nxiste përpjekjet dhe luftën për liri, barazi, drejtësi dhe pavarësi për popullin shqiptar.

Rilindja Kombëtare është një periudhë historike, e cila duke u mbështetur në sistemin e vlerave të shkollës së Korçës dhe shkollave të tjera, do të shndërrohet në një lëvizje të gjerë politike, kulturore dhe arsimore për ngritjen e ndjenjave patriotike dhe çlirimin e atdheut. Meqë gjuha ishte një nga elementet crucial i kombit, rilindësit mendonin se nëse nuk shkruhet dhe mësohet gjuha shqipe atëherë nuk do të ketë komb shqiptarë. Këto ide rilindësit i vunë në jetë duke hapur shkolla, klube dhe shoqëri, ndër të cilat ishte



edhe ajo e Korçës, e cila dha kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare shqiptare për pavarësi.

S'do mend se mësonjëtorja e Korçës si vatrë e arsimimit dhe emancipimit të popullatës u bë frymëzim për gjeneratat e reja se si duhet dashur atdheu dhe kombi. Shikuar historikisht, populli shqiptar ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ruajtjen e identitetit kombëtar. Në këto përpjekje një vend tepër të rëndësishëm pa dyshim ka luajtur arsimimi në gjuhën amtare. Rilindësit tanë shqiptarë si Naim, Sami dhe Abdyl Frashëri, Konstandin Kristoforidhi, Naum Veqilharxhi, Zef Jubani, Thimi Mitko, Pashko Vasa, Andon Zako Çajupi, Jani Vreto e shumë të tjerë, punuan vazhdimisht në këtë çështje madhore.

Konstandin Kristoforidhi lidhur me gjuhën shqipe dhe rëndësinë që ka ajo për kombin shqiptar do të shkruajë se, nëse gjuha shqipe nuk shkruhet, nuk do të kalojnë shumë vite dhe nuk do të ketë më Shqipëri në faqe të dheut dhe as nuk do të shënohet më emri Shqipëri në hartë të botës. Në këtë drejtim shumë personalitete dhe shoqata e shoqëri shqiptare si "Shoqëria e Stambollit", "Drita" e Bukureshtit dhe shumë shoqëri të tjera, nuk janë ndalur për senzibilizimin e çështjes shqiptare, qoftë përmes komunikimit politik, qoftë përmes veprimtarisë kulturore arsimore, siç ishte botimi i teksteve shkollore dhe shpërndarja e tyre në popullatën shqiptare.

Qëllimi i elitës politike dhe intelektuale të Rilindjes Kombëtare ishte përkushtimi për zhvillimin e arsimit kombëtarë të bazuar në gjuhën amtare. Pra, veprimtaria patriotike dhe iluministe e rilindësve tanë shqiptarë ishte përqendruar në iniciativën e shndërrimit të shkollave të huaja (greqishte, turqishte etj.) në shkolla shqipe, veprimtaria e të cilave do të përqendrohej në arsimimin shqip të popullit vendas. Në këtë drejtim vlen të përmenden sukseset e Petro Nini Luarasis, i cili disa shkolla greqishte në Kolonjë i ktheu në shkolla shqipe, pastaj Gjergj Qiriazi hapi një shkollë private shqipe në Manastir etj. Kështu patriotët shqiptarë vazhduan në insistimin për hapjen e shkollave shqipe derisa morën leje zyrtare për hapjen e një shkolle kombëtare në Korçë me 7 mars 1887, në të cilën drejtori i parë u emërua Pandeli Sotiri, një patriot dhe ideolog i madh shqiptar. Hapja e kësaj shkolle pati jehonë të madhe ndër shqiptarët, si te popullata e rëndomtë e veçanërisht te elita politike dhe intelektuale, sepse vërehej qartë

se tani çështja shqiptare do të hyjë në binarë të mirëfilltë. Jehona kombëtare e hapjes së kësaj shkolle ishte e madhe, sepse më pas u hapën edhe shkolla tjera dhe të gjitha u vunë në shërbim të çështjes kombëtare.

Shtatë marsi për shqiptarët, përveçse është ditëlindja e mësonjëtores gjithëkombëtare publike dhe zyrtare të Korçës, e cila së bashku me të gjitha shkollat tjera, qofshin ato më herët ose më vonë, qofshin ato fetare apo laike, kishin një ideal: mëvetësimin e shqiptarëve. Kjo datë, në anën tjetër, është edhe dita e mësuesit, përmes së cilës përkujtohet dhe vlerësohet veprimtaria e shenjtë edukativo-arsimore e tij. Duke folur dhe përkujtuar ditëlindjen e këtyre shkollave si vatra të diturisë, njëkohësisht na jepet e drejta të flasim edhe për bartësit e veprimtarisë edukativo-arsimore gjegjësisht për arsimtarët, të cilët institucionit të shkollës i japin kuptim, përmbajtje dhe vizion në kohë dhe hapësirë. Shtatë marsi jo rastësisht quhet Dita e Mësuesit, sepse edukatori (mësuesi) i cili përhap dituri, është një nga figurat më meritore dhe më markante që nga themelimi i shkollave shqipe e deri sot.

Veprimtaria edukativo-arsimore e mësuesit, përveç asaj që ka vlera iluministe, ajo ka përmbajtje edhe patriotike atdhetare sepse ai duke bërë përpjekje që të rinjtë t'i pajisë me dituri dhe shkathtësi, këta të rinj i përgatit për marrjen e roleve të reja në shoqëri që kështu të bëhen pjesë përbërëse e proceseve shoqërore.

Të gjithë patriotët dhe intelektualët shqiptarë, që i dolën në ndihmë atdheut, janë fryt i punës dhe veprimtarisë edukativo-arsimore të mësuesve, sepse ata në vazhdimësi e kishin përgatitur popullin që të dijë të flijohet për atdheun, qoftë me dije ose me armë. Duke marrë parasysh punën dhe veprën sublime të mësuesit për popullin e vet në përhapjen e diturisë, mjafton që së paku njëherë në vit të festohet me dinjitet dhe krenari kjo ditë dhe të përkujtohet puna dhe vepra e tyre, duke marrë parasysh edhe sakrificën dhe flijimin e tyre për çështjen kombëtare në të gjitha trojet etnike shqiptare. Jo rastësisht okupatori çdoherë në shënjestër e ka pasur pikërisht këtë kategori të mësuesve, të cilët janë përndjekur, burgosur, persekutuar dhe vrarë me qëllim të caktuar, që ta eliminojnë dhe zhdukun turpin e popullit shqiptar. Duke pasur parasysh kontributin e mësuesit dhe vlerat intelektuale dhe kombëtare, të cilat i ka dhënë dhe i jep në vazhdimësi ai për shoqërinë dhe atdheun,

shoqëria jonë shqiptare në gjithë hapësirën etnike duhet të ketë një qasje tjetërfare dhe më dinjitoze ndaj tyre. Respekti ndaj mësuesit, veçanërisht në aspektin institucional, duhet të jetë në një nivel më të lartë dhe më respektabil dhe, mos më tepër, bile të shpërblehen me ndonjë mirënjohje modeste si shenjë që ata nuk janë lënë pas dore dhe se veprimtaria e tyre edukativo-arsimore dhe patriotike kombëtare respektohet dhe vlerësohet.

/Shenja/

Mësonjëtorja e Korçës

Mësonjëtorja e Korçës është shkolla e parë e demokratike, kombëtare, dhe laike e gjuhës shqipe. Ajo u hap më 7 mars të vitit 1887 në Korçë nga ana e mësuesit patriot Pandeli Sotiri, në shtëpinë e ofruar për mësimdhënie nga atdhetari Diamant Terpo. Ndërtesa ku u hap kjo shkollë sot është muzeum kombëtar i arsimit. Mësues dhe drejtor i parë i saj ishte Pandeli Sotiri. Ai e filloi mësimin në gjuhën shqipe fillimisht me 35 nxënës. Hapja e kësaj shkolle për nga karakteri kishte tipare demokratike, pasi në të mësonin fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur. Kjo shkollë kishte një klasë përgatitore si dhe katër klasa të rregullta. Lëndët mësimore ishin shkrimi, këndimi, gramatika e gjuhës shqipe, historia, gjeografia, aritmetika, dituria natyrore dhe edukimi fizik.

Hapja e shkollës ishte një ngjarje dhe një fitore e madhe për gjithë lëvizjen kombëtare. Mësonjëtorja e Korçës ishte qendër e rëndësishme për formimin kulturor dhe ngritjen e ndërgjegjes dhe moralit në popull. Ajo nxiti edukimin patriotik të brezit të ri e të masave të gjera. Shkolla tërhoqi interesin dhe admirimin e shumë shqiptarëve, nën shembullin e saj u frymëzuan më vonë edhe banorë të viseve dhe trevave të tjera shqiptare.

Veç të tjerash kjo ngjarje ishte një fitore e madhe për popullin shqiptar, pasi deri atëherë dhënia e mësimave për shkak të pushtimit osman bëhej privatisht brenda shtëpive në mënyrë të fshehtë. Kështu, që nga ajo ditë, 7 marsi festohet në Shqipëri si dita e mësuesit për të përkujtuar atë ngjarje të rëndësishme kulturore dhe historike.

Edhe pse në kushte të vështira, kur mësimi i gjuhës shqipe për shkak të kushteve të ndodhura nën sundimin osman ishte rreptësisht i ndaluar, mësonjëtorja e Korçës qëndroi e hapur për gati 15 vjet. Drejtues të saj ishin figura të njohura të Rilindjes shqiptare si: Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Naum Naçi, Thoma Avrami, etj. Kontributi i madh që këta atdhetarë dhe veprimtarë të shquar dhanë për kombin dëshmohej nga dëshira e zjarrtë që ata kishin për të përhapur dijen në popull. Me ato mundësi që kishin ata u bënë iniciatorët e krijimit të teksteve të para shkollore të dokumentuara. Ata i përkushtuan një rëndësi të madhe pajisjes me mjetet e duhura të mësimdhënies për të bërë më tej dhe shpërndarjen e tyre te nxënësit e tyre. Të edukuar dhe me frymën e lartë të patriotizmit këta nxënës do të bëheshin në të ardhmen dhe pasuesit e denjë të ideologjisë së mësuesve të tyre dhe luftëtarë të devotshëm për luftën për liri dhe pavarësi. [4]

Në shenjë nderimi, respekti dhe kujtimi për kontributin e Mësonjëtores së Korçës dhe mësuesve të saj, 7 marsi është caktuar si ditë e mësuesit dhe shkollës shqipe. /Wikipedia/



Takim i kryebashkiakut Mziu me Orlando Fusco, Oficer Programi për Qeverisje të Mirë, i Delegacionit të BE-së

Takimi u zhvillua në kuadër të ngritjes së Këndit të BE në Bashkinë Kamëz

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në një takim zyrtar Oficerin për Programet për Qeverisje të Mirë, i Delegacionit të Bashkimit Evropian në kuadër të ngritjes së Këndit të BE në Kamëz. Tashmë, Kamza ka Këndin e BE-së të ngritur në ambientet e Bashkisë, që do të kryejë funksionet për të cilat është ngritur. Në qendër të takimit zyrtar që kryebashkiaku Mziu pati me z. Fusco, ishte asistencë e mëtejshme për rritje kapacitësh nga ana e Delegacionit të BE-së në Shqipëri; rritja e partneritetit me partnerë strategjikë rajonalë; instrumentet financiare të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, me mundësi aplikimi për Bashkinë Kamëz; mundësitë e Delegacionit të BE-së në Shqipëri për të financuar në fushën infrastrukturale, sociale etj.

Disa nga funksionet e Këndit të BE në Kamëz janë: përgjigjja ndaj pyetjeve të qytetarëve dhe grupeve në lidhje me BE; marrja e kërkesave të qytetarëve në lidhje me informacionin që duan ata nga dhe për BE-në dhe përcjellja e pyetjes tek ekipi MfE; shpërndarje publikimesh për publikun; kthim përgjigjeje direkt ose online për programet e BE – Komponenti IPA dhe IPA Programmes; dhënie informacioni të dedikuar për qytetarët në lidhje me mundësitë që ofron BE sipas interesave të tyre; mundësi për studentët në lidhje me politikën e BE-së për mbështetjen e bursave të studimit në vende që ofrojnë mundësi të tilla etj.

Rreth projektit “Bashkitë për në Evropë

Projekti “Bashkitë për në Evropë” është një nismë e Bashkimit të Evropës, e cila synon të rrisë kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri në kuadër të procesit të integritimit evropian të vendit, duke ngritur në secilën bashki një zyre të BE-së që do të jetë edhe pika e referencës në çdo bashki, jo vetëm për punonjësit e administrative vendore, por edhe për të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit në nivel vendor.

Në procesin e funksionimit të Këndeve të BE-së, këta të fundit kthehen në bashkëpunëtorin më të ngushtë të projektit, duke pasur dy funksione brenda tyre:

- Forcimi i kapaciteteve të njësive të tyre të qeverisjes vendore në lidhje me funksionimin e tyre brenda standardeve evropiane si dhe përthithja e fondeve evropiane mbi bazë projektsh.
- Të shërbejnë si pika kontakti për njësinitë e tyre të qeverisjes vendore, por edhe për të gjithë shoqërinë në rajonin e tyre, në lidhje me informimin për Bashkimin Evropian.

A. Këndet e BE, me mbështetjen e projektit “Bashkitë për në Evropë”, luajnë rolin e forcimit të kapaciteteve të njësive të tyre të qeverisjes vendore në lidhje me funksionimin e tyre brenda standardeve evropiane si dhe përthithja e fondeve evropiane mbi bazë projektsh. Në këtë proces rroli dhe shërbimet e projektit si dhe i Këndeve të BE në secilën bashki është:

- Të rrisin ndërgjegjësimin në NJQV-të e tyre, mbi Instrumentin e Paraadimit (IPA) si dhe fondeve të tjera të Bashkimit Evropian të vlefshme për bashkitë shqiptare



dhe qytetarët e tyre nëpërmjet historive të suksesit me projekte konkrete.

- Të rrisin kapacitetet e palëve të interesuara në NJQV-të e tyre, në fushën e përfuturit të fondeve IPA si dhe fondeve të tjera të BE, nëpërmjet transmetimit të njohurive se si të shkruajnë dhe konceptojnë një projektpropozim dhe të përmbushin aplikimet e duhura.
- Të rrisin njohuritë dhe kuptimin e qartë të BE në NJQV-të e tyre, objektivat, politikën, prioritetet, institucionet dhe perspektivat e BE, si dhe të ofrojnë informacionin e duhur për mitet apo keqkuptimet në procesin e pranimit të Shqipërisë në BE.
- Të rrisin në bashkitë e tyre, kapacitetet për të marrë, përvetësuar dhe shpërndarë informacion në lidhje me BE, të përshtatshëm si për publikun ashtu edhe për punonjësit e NJQV-ve të tyre.
- Të rrisin kapacitetet e bashkive të tyre, si për publikun ashtu edhe për administratat e bashkive, për të marrë informacion, por edhe opinione e mendime, të cilat mund të informojnë qeverinë shqiptare, por edhe partnerët ndërkombëtarë evropianë, në lidhje me planifikimin e ndërhyrjeve të tjera.
- Të rrisin sinergjitë në NJQV-të e tyre, me aktorë të tjerë si dhe palë të interesuara, në mënyrë të veçantë me Shtëpinë e Evropës (House of Europe) në Tiranë, shtetet anëtare të BE, me qëllim marrjen e informacionit mbi BE-në, ndarjen e eksperiencave më të mira me vendet e BE dhe procesin e integritimit të Shqipërisë në BE.

B. Këndet e BE, me mbështetjen e projektit “Bashkitë për në Evropë”, duhet të shërbejnë si pika kontakti për njësinitë e tyre të qeverisjes vendore, por edhe për të gjithë shoqërinë në rajonin e tyre në lidhje me informimin për Bashkimin e Evropian. Në këtë proces, roli i Këndeve të BE në bashkëpunim me projektin Bashkitë për në Evropë është:

- T’u përgjigjet pyetjeve të të gjithë qytetarëve apo grupeve të interesit në bashkinë e tij, në lidhje me të gjithë informacionin që ka të bëjë me BE, duke përfshirë, fondet, politikën, të drejtat e njeriut etj.
- Të ftojë qytetarët e të gjitha grup-moshave dhe profesionëve që të vizitojnë Këndin e BE dhe të njihen me nga afër me çdo

gjë që ka të bëjë me BE-në.

- Të shpërndajë njohuri, dokumente dhe publikime të botuara nga BE apo të përkthyer në shqip nga aktorë të ndryshëm institucionalë apo të shoqërisë civile në Shqipëri si dhe projekte të financuara nga BE në lidhje me BE.
- Të shërbejë si një burim informacioni për çdo çështje që lidhet me BE dhe që shqetëson qoftë anëtarë të stafit të bashkisë, qoftë komunitetin, pa dallim grup moshe apo shtrese sociale e përkatësie fetare.
- Të shërbejë si një qendër reference për shoqërinë civile në rajonin ku ndodhet, në lidhje me informacionin që ka të bëjë me programet e ndryshme të financimit nga fonde të ndryshme të BE.
- Të aksesojë dokumentet dhe publikimet zyrtare të Bashkimit Evropian, online apo të printuara dhe t’i shpërndajë ato tek stafi i NJQV-së, si edhe tek e gjithë popullata që është e interesuar për to.
- Të organizojë takime të shpeshta me grupe të ndryshme interesi apo të popullatës në rajonin e tij, me qëllim shpjegimin e BE: politikën, institucionet, prioritetet, procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, fondet e ndryshme evropiane në dispozicion për ta etj.
- Në rastin e planifikimit të një eventit që lidhet me një çështje të caktuar të BE, të sigurojë nëpërmjet projektit “Bashkitë për në Evropë”, prezencën e një eksperti “EU speaker” i cili mund të lehtësojë më shumë dhënie e njohurive të duhura ndaj grupit të interesit në atë fushë për të cilën është organizuar ky event.
- Të organizojë vizita studimore me studentët, shoqërinë civile apo edhe grupe të ndryshme, pranë Këndit të BE, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur rreth BE sipas kërkesave të vetë grupeve apo individëve që kërkojnë një shpjegim për një çështje të caktuar.
- Së bashku dhe me mbështetjen e ekipit të projektit, të organizojë një event madhor në NJQV-në e tij, në lidhje me një tematikë të caktuar rreth BE-së.
- Të realizojë një kalendar të qartë aktivitetesh informuese në lidhje me informimin e qytetarëve rreth BE-së.
- Këndi i BE-së dhe kanalet e tij të komunikimit janë një përçues vendor i mesazheve që vijnë nga Delegacioni i BE-së në Tiranë si dhe shtetet anëtare të BE të akredituara në Shqipëri.

Bashkia Kamëz aplikon si lider projektin “BE EU Citizens: Building Europe through civic participation”

Bashkia Kamëz aplikon si lider në projektin “BE EU Citizens: Building Europe through civic participation” në grantet e Bashkimit Evropian, programi “Evropa për Qytetarët”, masa “Rrjetëzimi i qyteteve”.

Projekti “BE EU Citizens: Building Europe through civic participation” ka si qëllim nxitjen e shtetësisë evropiane dhe të pjesëmarrjes qytetare demokratike në nivel vendor. Projekti do të konsistojë në ngritjen e një rrjeti evropian nëpërmjet aktorëve publikë e privatë vendorë duke vepruar në inkurajimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset e vendimmarrjes ku do të përfshihen disa grupe si: qytetarët (ekspertë të fushave të ndryshme, OJF të rinjtë, gratë); përfaqësues institucionalë (kryetarë, drejtorë, përfaqësues të fushave specifike lidhur me angazhimin demokratik dhe pjesëmarrjen qytetare).



Projekti do t’u kushtojë vëmendje të veçantë dy tematikave të rëndësishme, si:

-Debat mbi të ardhmen e Evropës dhe sfidat e euroskepticizmit; -Viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore 2018.

Veçanërisht ky projekt parashikon 5 evente evropiane/konferenca, të cilat do të zhvillohen në Kamëz (Shqipëri); Gornja Rijeka (Kroaci); Bar (Mal i Zi); Vjenë (Austri). Ky projekt është i lokalizuar në 4 shtete të ndryshme, do të ketë një shtrirje kohore prej 21 muajsh dhe do të ketë një numër total pjesëmarrësish prej 898. Projekti do të bashkojë qytetarë, bashki, ekspertë, aktorë të shumtë të shoqërisë civile, të rinj, gra, vullnetarë, në favor të angazhimit demokratik në mënyrë që të krijohet një rrjet evropian, me qëllim për të reflektuar mbi qytetarinë evropiane, kuptimin dhe vlerën e saj për të ardhmen e Evropës.